

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me anëtarët - gjyqtarët profesionistë Ilir Bytyqi dhe Mustafë Tahiri, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.T., për shkak të veprës penale në vazhdim grabitja nga neni 329 par. 1 i KPRK-së, veprës penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr. 13/14 të dt. 24 prill 2014 dhe PP/I.nr. 28/15 të dt. 10.03.2015, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shukri Jashari, të akuzuarit Sh.T. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Z.Z., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 27/28.05 2015, 14 korrik 2015, kurse me dt. 15.07.2015, mori dhe publikisht shpalli kurse me dt.20.07.2015, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari SH.T., data e lindjes....., ne fsh.....Komuna e Shtimes, nga i ati N. dhe e ëma M., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa pune, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, me vendbanim ne rr.” Komuna e Shtimes,

ËSHTË FAJTOR

sepse

me dt.28.12.2013 rreth orës 18.30 në rrugën “Liman Reka” në Ferizaj, tek tregu i veturave me qëllim që vetes ti sjelle dobi pasurore të kundërligjshme me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit A.A.1, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ka qenë duke ecur rrugës është ndalur nga i pandehuri i cili ka kërkuar qe t’ia jep unazën e fejesës kinse për ta shikuar dhe ia merr unazën e fejesës të arit në vlerë prej 80 euro (tetëdhjetë euro) dhe në momenti qe i dëmtuari kërkon unazën nga i pandehuri i pandehuri i eshte kanosur me nje thike flutur dhe pastaj merr unazën dhe ik nga vendi i ngjarjes,

me dt.12.01.2014 rreth orës 18.00 në rrugën “Brahim Ademi ” në Ferizaj, në oborrin e shkollës së mesme “.....”, me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Rr.H., nxënës i shkollës së mesme, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ka qenë duke ecur rrugës se bashku me K.B., i pandehuri i del përpara dhe i ka pyetur “mos keni drogë në xhepa” në mënyrë kërcënuese dhe i thotë të nxjerr të gjitha sendet në xhepa, ku i dëmtuari Rr.H. nga frika nxjerr protofolin nga xhepi dhe ia jep të pandehurit ku ka pasur para ne vlere prej 350 (treqind e pesëdhjetë) euro, i pandehuri merr parat nga i dëmtuari dhe vë dorën në brez duke treguar revolen me qëllim frikësimi dhe ik nga vendi i ngjarjes,

me dt.19.01.2014 rreth orës 13.30 në rrugën “Brahim Ademi” në Ferizaj, tek parku Liria, me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit Sh.H. dhe V.A.1, nxënës i shkollës së mesme derisa të njëjtit ishin duke ecur, në atë mënyrë që duke mbajtur dorën në brez me qëllim frikësimi dhe pastaj ka urdhëruar Sh.H. që ti zhvesh gjitha rrobat dhe i njëjtit ka vepruar sipas urdhërave të të pandehurit, pastaj ka marr rrobat e tij te cilat i ka veshur për vete ndërsa rrobat e veta ia ka dhënë të dëmtuarit Sh.H. ndërsa V.A.1 i merr një telefon Samsung me numër të IMEIT 354267045809354 dhe ik nga vend i ngjarjes,

me date 20.01.2014 rreth orës 10.00 në Shtime në rrugën “Skender Salihu” saktësisht në qendrën rinore, me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme i ka detyruar të miturit Xh.K. nxënës në shkollën e mesme ta nxjerr portofolin në të cilën ka pasur para prej 190 euro (njëqind e nëntëdhjetë euro) në atë mënyrë që vazhdimisht duke mbajtur dorën te brezi me qëllim frikësimi gjithashtu edhe nga L.K. ka kërkuar para por i njëjti nuk ka pasur andaj i pandehuri i merr te dy të dëmtuarit te cilit i ka dërguar afër një mali duke ju premtuar se ja jep nga nje libër te kuranit

me dt.25.01.2014 rreth orës 11.30 në rrugën “Brahim Ademi” ne Ferizaj te ish objekti radio me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit A.A. te ja jap portofolin i cili ishte se bashku me A.B. ku i pandehuri nga A.A. merr dy euro e gjysmë e pastaj nga A.B. me dhunë merr portofolin ku në të kishte para 65 € dhe pastaj A.T.1 e kontrollon nëpër xhepa ku merr një telefon Nokia ngjyre te zeze me numër te valës me vlere prej 40 euro te cilin ia merr si dhe duke i thënë me fjalët kërcënues se ju nuk guxoni ti tregoni as kujt

me dt.26.01.2014 rreth orës 15,30 në Ferizaj rrugën Brahim Ademi tek parku Liria , në Ferizaj me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurin e luajtshme dhe me kanosje serioze dhe atë me një revole ngjyre te zeze i është drejtuar te dëmtuarve A.T.2 N.M. dhe V.A.2 ku ne fillim ka pyetur se te hane qenen pitbull dhe pastaj i ka propozuar qe te shkojnë qe ta shohë qenin pitbull gjete rrugës i ka pyetur mos e pini barin pastaj ka kërkuar portofolin nga A. T.2 i cili ja ka dhënë portofolin duke menduar se është ndonjë police civile dhe i pandehuri po sa ka kontrolluar portofolin i është kthyer te dëmtuarit V.A.2 ja merre telefonin Samsung se bashku me kartën ku me vone telefonin ja kthen por gjithashtu nga kuleta ja merre edhe 5 euro nga i cili ka kërkuar portofolin dhe pastaj ka kërkuar telefonin dhe ka detyruar A.T.2 qe ti ja jep telefonin dhe gjate kohës deri sa i pandehuri ja marr telefonin Iphon 5 ngjyre te zeze dhe sim Kartele dhe 8 euro nga dore te njëjtëve detyron ti nxjerr te gjitha te holla dhe qe te shkon tre hapa mbrapa duke e mbajtur dorën ne brez si dhe duke i kërcënuar me fjalët mos e ktheni kokën mbrapa se te treve ju vrase vazhdimisht duke e treguar armen te cilinë ka mbajtur ne brez

me dt.22.02.2015 rreth orës 18,00 me qellim te përfitimit te kundërligjshëm te dobisë pasurore për vete i pandehuri me përdorimin e forcës dhe me kanosje serioze e ka detyruar te dëmtuarin A.O. i cili kishte ndalur veturën ne rrugën kryesore Rakaj - Ferizaj ne atë mënyrë gjersa i dëmtuari A.O. ishin me veturës Golf 5 ngjyre te kaltert me targ se bashku me L.P. D.H. e te cilët ishin ndalur për momentin për te kryer nevoja fiziologjike, dhe kishin dal nga vetura jashtë ne ate moment i pandehuri Sh.T. i cili ishte se bashku me Q.U., i është afruar te dëmtuarit A.O. nen kërcënimin e armës dhe atë arme – pune dore te cilit ne fillim i ka kontrolluar te trete ne trup” duke ju thënë se nxjerrin te gjitha gjera te cilët i kenin neper xhepa” ku te dëmtuarit kane vepruar ashtu, pastaj kane hypur te dy ne veturën jene ulur ne ulësen e prapme ku i pandehuri tere kohen ja mbajtur armene ne shpine te dëmtuarit A.O. dhe duke i thene me fjalët “vozite deri ne fshatin Duraj K. Kaçanikut” dhe pastja ka kërkuar nga A.O. qe L.P. dhe D.H. ti le ne rruge kurse nga i dëmtuari A.O. ka kërkuar qe ta merre ne shtëpinë e tije se bashke me Q.U. qe ta kalojnë natën i cili i ka marre te dyte i ka dërguar ne shtëpinë e vllahut te tij i cili eshte jashtë vendit dhe te nesërmen me datën 23.02.2015 rreth orës 07.20 i pandehuri e ka detyruar te dëmtuarin A.O. qe te ja jap veturën e tij Golf 5 te cilën e kane marre me qellim qe te kryen nje vepër tjetër penale me arsyetim se kemi per te thyer kazinonë e cila gjendet afër restorantin Evropa, ku nga i dëmtuari A.O. ka kërkuar para prej 100 euro (njëqind euro) po qe i njëjti nuk ka patuar po qe te njëjtit ja kane marr 15.00 euro (pesëdhjetë).

me të cilën kreu veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së

nga data e pacaktuar deri më datën 22.02.2015, pa autorizim ka mbajtur në posedim armën dhe atë pistoletën punë dore në kundërshtim me ligjin mbi armët,

me të cilën kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të nenit 329 par. 2, nenit 340 par.1, nenit 374 par. 1 si dhe neneve 4, 7, 17,18, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 80, 83 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

për veprën penale veprën penale në vazhdim grabitja nga neni 329 par.1 i KPRK-së, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tri/vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 /treqind/€,

për veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1/një/ viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 /treqind/ €,

për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 300 /treqind/ €,

Ashtu që në bazë të dispozitës së nenit 80 të KPRK-së, i shqipton:

DËNIM UNIK BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3/TRE/ VITE E 6 /GJASHTË/ MUAJ SI DHE DËNIM UNIK ME GJOBË NË SHUMË PREJ 900 /NËTËQIND/ €.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me neni 46 paragrafi 3 të KPRK-ës ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20€ do të vuaj nga një ditë burgimi.

Bazuar në nenin 83 par.1 tëm KPRK-së, në dënimin e shqiptuar do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, prej dt. 28.01.2014 deri më 04.10.2014 si dhe nga dt. 23.02.2015 deri më 15.07.2015.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma pistoletë punë dore.

Në bazë të nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPP-së Gjykata me aktvendim të veçantë ka vazhduar masën e paraburgimit deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë mirëpo jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

Të dëmtuarit: A.A.1, Sh.H., V.A.1, A.T.1, A.T.2, V.A.2 dhe A.O., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil, kurse obligohet i akuzuari që të dëmtuarit Rr.H., t'ia kthej shumën prej 350€, të dëmtuarit Xh.K., t'ia kthej shumën prej 190€, të dëmtuares A. B., t'ia kthej shumën prej 60€, kurse i dëmtuari N.M., nuk ka paraqitur kërkesë pasurore - juridike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 /njëqind/€ në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II

Në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

me dt.20.12.2013 rreth orës 13.20 në rrugën “Tahir Sinani” në Ferizaj, me përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme të dëmtuarit E.E. dhe A.E. nxënës të shkollës së mesme në atë mënyrë që deri sa të dëmtuarit kanë qenë duke ecur rrugës i ka dal përpara i pandehuri dhe ka kërkuar prej tyre ti nxjerrin të gjitha sendet të cilat i kanë patuar në xhepa me aryetimin se mos kanë substancë narkotike ku i pandehuri duke ju kanosur me një thikë në dorë ti nxjerrin të gjitha gjerat ashtu që të dëmtuarit E.E. i merr telefonin celular Ipohn 5 ngjyrë të zezë dhe 10 euro (dhjet euro), ndërsa të dëmtuarit A.E. i është drejtuar me fjalët kerconuese keni kujdes se ju lë këtu dhe mos të iu shoh duke shkuar në polici,

me dt.27.01.2014 rreth orës 17.30 në rrugën “Brahim Ademi” në Ferizaj të ish objekti radio përdorimin e forcës ka përvetësuar pasurinë e luajtshme me kanosje serioze i është drejtuar M.N. dhe L.R. ku në fillim ju është drejtuar me fjalët une jam policë civil pastaj mos jeni përdorues të narkotikeve apo mos jeni duke shitur drog dhe nga të njëjtit ka tentuar që ti nxjerrin nga gjepi të gjitha gjera që kanë pasur me veti ku dëmtuarës M.N. e ka pyetur mos ka diçka në qante si dhe i ka thanë që ta hap qartën për ta kontrolluar dhe nga gjepi ja ka marr një

telefonin Iphon 4 ngjyre te bardhe me kartel ndërsa te dëmtuarit L.R. një telefon Nokia me numër dhe nje zinxhirë te argjendit te dorës si dhe duke ju kërcënuar se ecni ne shtëpi ku telefonin me vone e ka shitur ne vlere prej 150 euro

meqë Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza për veprën penale vazhdim grabitja nga neni 329 par. 1 i KPRK-së, veprës penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së

Të dëmtuarit E.E., M.N. dhe L.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën ndaj të akuzuarit Sh.T. të evidentuar PP/I.nr. 13/14 të dt. 24 prill 2014 për shkak të veprës penale në vazhdim grabitja nga neni 329 par. 1 i KPRK-së si dhe aktakuzën PP/I.nr. 28/15 të dt. 10.03.2015, për veprën penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së dhe veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 2 të KPRK-së mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale fillimisht mbajti shqyrtimin fillestar me datë 08.05.2014 kurse pas paraqitjen e aktakuzës tjetër, Gjykata me aktvendim të veçantë bashkoi procedurën penale duke vazhduar me shqyrtimin fillestar me dt. 31.03.2015, kurse i akuzuari u deklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e akuzës, për të vazhduar me shqyrtimin gjyqësor me datat 27/28.05 2015 dhe 14/15 korrik 2015, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-Prokurori i Shtetit Shukri Jashari, në fazën e ndryshimit të aktakuzës ka ndryshuar të njëjtën siç është përkthyer në dispozitivin e këtij aktgjykimi kurse, deri në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe të i shqiptohet dënimi i paraparë sipas ligjit, për shkak të veprave penale siç është përkthyer në aktakuzë

2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprat penale sipas dy aktakuzave, duke mohuar fillimisht se të dëmtuarit A.O. i ka marrë automjetin e tij, por duke pohuar se me të janë njohur një kohë të gjatë dhe se kanë pasur disa biznese të përbashkëta, e duke elaboruar se e njeh edhe familjarisht me që i njëjti banon në afërsi të nipave të tij, e që i njëjti personalisht ia ka dhënë çelësat e automjetit të tij “Golf V” derisa aty ka qenë edhe Q.U., e po ashtu dokumentet e automjetit ia ka lënë në automjet, përkatësisht automjetin nuk ia ka marrë por se vet ia ka dhënë A.O. deh pas kontakteve telefonike ka pasur që automjetin të ia kthej tek restorant “.....” përkatësisht afër kazinos që gjendet afër këtij restoranti. Më tutje i akuzuari nuk ka kontestuar faktin se një natë ka fjetur së bashku me Q.U. në shtëpinë e A.O. por se pohon se kjo ndejë ka qenë normale dhe se i njeh edhe kushërinjtë e A.O. -N. dhe të tjerët, kurse arsyen e paraqitjes së rastit nga ana e A.O. e ka ndërlidhur me faktin se nuk ia ka kryer një punë në Gjilan edhe pse nuk e ka specifikuar se për çfarë pune bëhet fjalë, po ashtu ka vazhduar me mbrojtjen e tij se gjatë qëndrimit atë natë kanë ngrënë ushqim dhe kanë pirë birra së bashku. Nuk e ka mohuar se ka poseduar armën, por se kjo armë nuk ka pasur municion dhe nuk ka funksionuar pasi që personalisht i ka hequr xhilpërën e shkrepjes.

Gjithashtu i akuzuari ka mohuar kryerjen e veprave tjera penale të grabitjes duke u arsyetuar se nuk i njihete asnjë nga këta të dëmtuar dhe se në këtë kohë kur kanë ndodhur këto vepra penale ka qenë në burg

Sa i përket rastit në lidhje me të dëmtuarit Sh.H. dhe V.A.1 nuk e konteston faktin se i ka marrë rrobat dhe telefonin por se kjo ka ndodhur në fsh. Lloshkobare tek shtalla e F.J. dhe jo tek parku Liria e po ashtu në fshatin Dremjak nuk e pranon se ka marrë sende nga të dëmtuarët A.T.2, V.A.2 dhe N.M. dhe kjo ka ndodhur në fshatin Dremjak dhe nga fakti se këtra persona kanë vjedhur në vendin ku i akuzuari ka punuar përkatësisht në shtallën e F.J., por se sendet të nesërmen ia ka kthyer të dëmtuarve.

2. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;
- përmes dëgjimit të dëshmitarëve: E.E., A.E., A.A.1, Rr.H., V.A.1, Xh.K., L. K., A.A., A.T.2, V.A.2, N.M.,M.N., L.R., I.Z., A.O., L.P. dhe D.H., si dhe leximit të dëshmive të dëshmitarëve K.B. dhe Sh.H.¹;
- përmes shikimit dhe leximit në zinxhirin e ruajtjes të dt. 24.02.2014;
- përmes shikimit dhe leximit në vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve të dt. 19.01.2014, ku nga dëshmitari Sh.H. janë konfiskuar një xhamper, një palë pantallona dhe një palë këpucë;
- përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku janë marrë nga Sh.H. gjithashtu një jakne ngj. e zezë, një palë patike Rebook ngjyrë të zezë dhe një telefon i tipit Samsung;
- përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku janë marrë nga T.G. gjithashtu një jakne ngj. e zezë, një palë patike Rebook ngjyrë të zezë dhe një telefon i tipit Samsung;
- përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku Sh.T. i janë kthyer sendet një xhamper ngjyrë hiri pantallona ngj. të kaftë dhe këpucë ngj. të zezë;
- përmes shikimit dhe leximit në vërtetimi tërheqja e parave të;
- përmes shikimit dhe leximit në zinxhirin e ruajtjes të dt. 23.02.2015, ku janë konfiskuar sendet si në vijim: një pistoletë punë dore, një letërnjoftim, një kartelë e studentit, 4 kartela të telefonave dhe atë një e valës një e ipkos dhe dy z-mobile;
- përmes shikimit dhe leximit në Ekzaminimin psikiatrik të dt. 11.03.2015, i cili ekzaminim është pëpiluar bazuar në ekspertimin e hospitalizuar prej dt. 01.09 – 08.09.2014, si dhe ekzaminimi ambulantor prej dt. 25.02.2015 – 02.03.2015;
- përmes shikimit dhe leximit në njoftimin nga Qendra e Korrektuese e Kosovës – Dubravë e dt. 29.05.2015;

¹ Këto dëshmi janë lexuar meqë sipas Memorandumit Zyrtar të lëshuar nga ana e Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Ferizaj i dt. 10.11.2014 dhe 18.11.2014 me nr. i Ref. SEK/352/2014 ku është konstatuar se dëshmitari K.B. gjindet në Norvegji kurse Sh.H. në Gjermani dhe sigurimi i prezencës së tyre në këtë shqyrtim ishte i pamundur.

- përmes shikimit në fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht para se të i vlerësojmë dëshmitë e dëshmitarëve është e nevojshme që të qartësohet së dëshmitë e dëshmitarëve E.E., A.E., M.N. dhe L.R., nuk do të vlerësohen fare pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza për këto dy pika të dispozitivit të aktakuzës në mungesë të provave, kurse sa i përket dëshmitarit I.Z. i njëjti ishte përfshirë në aktakuzë për shkak të gabimit teknik pasi që nuk kishte të bënte me asnjë pikë të aktakuzës, andaj Prokurori i Shtetit është tërhequr nga dëgjimi i këtij dëshmitari.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit A.A.1 është vërtetuar se vitin e kaluar te pazari i automjeteve përkatësisht tek poligoni në Ferizaj, derisa ka qenë vet, ka takuar tani të akuzuarin Sh.T. të cilin e ka njohur në bazë të një shokut të dajës së tij– J. nga fsh. dhe pasi është takuar me Sh.T., i njëjti ka nxjerrë një thikë dhe ka kërkuar para dhe gjëra të tjera dhe pastaj i ka marr kuletën me një shumë të vogël të parave 1.5 - 2€, kurse nga gishti i dorës së djathtë i ka hequr dhe i ka marrë unazën e fejesës me vlerë rreth 70-80€, të cilën ia ka hequr nga gishti.

Dëshmitari ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, për më tepër dëshmia e tij ishte e plotë dhe besueshmëria e saj rritet se paraqet fakte që ndërlidhen me frikën reale që kishte dëshmitari dhe nuk rezistoi edhe gjatë marrjes së unazës nga i akuzuari. Sa i përket njohjes së të akuzuarit kjo as që u diskutua fare pasi që dëshmitari sqaroi edhe faktin se të akuzuarin po e njohte edhe paraprakisht me emër dhe mbiemër përmes shokut të tij përndryshe dajë i të akuzuarit, për më tepër edhe me rastin e paraqitjes së rastit në polici dëshmitari denoncimin e bëri pikërisht për tani të akuzuarin dhe kjo vërteton faktin se dëshmitari as që e vënte në pyetje identitetin e të akuzuarit se pikërisht i akuzuari ishte personi që e kishte kryer këtë vepër penale.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit Rr.H., është vërtetuar në vitin 2014 kishin dalë me shokun e tij K.B. te shkolla e në Ferizaj afër sallës së sporteve “Bill Klinton” në Ferizaj dhe derisa kanë qenë duke qëndruar të ulur, ka shkuar një person, i cili është paraqitur si polic, duke bërëtitur dhe ka kërkuar të dalin mbrapa shkollës dhe ka marrë kuletën dhe nga aty shumë prej 250-300€, të cilat i ka pasur të vendosura në kuletë dhe pastaj ka marr edhe telefonin “iPhone 5”, të cilin e ka fikur dhe ia ka kthyer e gjithashtu ia ka kthyer edhe kuletën e zbrazët – pasi që parat i ka marrë. Më tutje ka shtuar se pasi e ka paraqitur rastin në polici dhe pasi i kanë

prezantuar fotografinë e të akuzuarit ka parë se pikërisht i akuzuari ka qenë personi që i ka marrë paratë.

Dëshmia e dëshmitarit ka qenë e saktë dhe objektive, i njëjti natyrshëm ka sqaruar rastin duke përshkruar edhe mënyrën e të akuzuarit duke i mbizotëruar të dëmtuarit me sjelljen e tij agresive e për më tepër dëshmia e tij është plotësuar edhe nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit K.B. i cili gjithashtu ngjarjen e përshkroi me saktësi të lartë dhe të hollësishme duke pohuar faktin se është vërtetuar kishin dalë me shokun e tij Rr.H. në oborrin e shkollës “.....” ku aty ka shkuar një person dhe është prezantuar si polic duke bërë titull dhe e ka detyruar Rr.H. që ti jep dëshmitarit paratë dhe pastaj ia ka dhënë paratë prej 350€, po ashtu ia ka marrë edhe telefonin por pasi që e ka fikur atë ia ka kthyer. Dëshmitari ka pohuar faktin se pasi rastin e ka paraqitur në polici e ka njohur personin që e ka parë në fotografi.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit **V.A.1**, është vërtetuar se duke shëtitur te Parku i Lirisë së bashku me shokët e tij Sh.H., A.H., A.A.2 dhe B.H., kanë takuar një person i cili fillimisht është sjellur mirë duke pyetur për faktin se a kishin armë apo diçka të ngjashme me vete pas bisedës i ka thënë Sh.H. se e ka një klyshë me ja dhënë dhe pastaj janë nisur deri te një vend dhe dorën e ka mbajtur te brezi dhe i ka thënë Sh.H. që të i desh teshat e tij dhe pastaj teshat ia ka marrë Sh.H. e më pastaj nga dëshmitari i akuzuari ka kërkuar dhe pastaj i ka dhënë telefonin samsung me kapak pasi ka qenë i frikësuar.

Dëshmi të ngjashme ka rrëfyer edhe dëshmitari, Sh.H., i cili ka përshkruar ngjarjen se me dt.19.01.2014, ka qenë me shokët e tij V.A.1, A.H., A.A.2 dhe B.H. duke shëtitur te Parku i Lirisë, aty kanë takuar të akuzuarin dhe pas bisedës me të për rrobat që i kishte veshur, i akuzuari ka kërkuar që rrobat që i kishte të veshura i dëmtuari në trup ti hiqte dhe të cilat pastaj i merr i akuzuari kurse rrobat e tij ia jep të dëmtuarit e që nga frika se i akuzuari mbante dorën në brez e ka bërë një gjë të tillë e që pas kësaj i akuzuari është larguar nga aty.

Dëshmitë e dëshmitarëve janë të sakta dhe nuk pati as edhe një rrethanë që dëmtonte kredibilitetin e dëshmive të tyre për më tepër këto dëshmi plotësojnë njëra –tjetrën e gjithashtu është e rëndësishme se këto dëshmi ishin të ngjajshme edhe në fazat e tjera të procedurës penale.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit, Xh.K. është vërtetuar se me dt. 20.01.2014, rreth orës 10:00 së bashku me shokun e tij L.K. kanë shkuar në Shtime përkatësisht në oborrin e

shkollës fillore “.....” që të shëtisin dhe të bëjmë disa fotografi si kujtim nga shkolla ashtu që duke u shëtitur ka shkuar pikërisht tani i akuzuari e i cili u ka thënë fillimisht se janë persona që shesin bari-hashahsh pastaj ka kërkuar që të nxjerrë sendet ashtu që nga kuleta i ka kërkuar dhe ia ka dhënë shumën prej 190 euro dhe duke i thënë që të shkojnë në polici së bashku meqë këto janë parat e shitjes se hashashit, përveç kësaj i njëjti ka kërkuar edhe një telefon por nuk ia ka dhënë e pastaj kërkoj që të shkojmë deri te një trafo dhe aty të ju jep një libër që ta lexojnë dhe kur kanë shkuar i akuzuari nuk ishte aty, e që rastin e kanë paraqitur në polici duke qenë i sigurve se pikërisht i akuzuari i ka marrë paratë, për më tepër nuk e mohoi faktin se paratë ia kishte dhënë vet pas kërkimit të tyre por këtë e ka bërë nga fakti se i akuzuari dorën e ka mbajtur te brezi dhe është ndier i kërcënuar, gjithashtu ka paraqitur kërkesë pasuroro juridike shumën prej 190 euro.

Po ashtu pothuajse dëshmi të ngjashme për këtë pikë të aktakuzës ka paraqitur edhe dëshmitari tjetër L.K., i cili ka pohuar faktin se në muajin janar 2014, së bashku me Xh.K. kanë shkuar tek shkolla lart në kodër te kisha dhe aty derisa kanë qenë duke i bërë disa fotografi me telefon ka ardhur një person dhe i cili ka biseduar së pari diçka por që përmbajtja e kësaj bisede nuk i kujtohet e pastaj ka kërkuar që të i nxjerrim kuletat dhe të i japim kuletat e pasai që ia kanë dhënë dhe pas shikimit në kuletën e tij nuk ka gjetur asgjë ia ka kthyer, kurse në kuletën e Xh.K. ka gjetur 3 bankënota nga 50 euro dhe 2 bankënota nga 20 euro ashtu që paratë i ka marrë kurse kuletën ia ka kthyer. Më tutje ka shtuar se gjatë bisedës i akuzuari e ka mbajtur vazhdimisht dorën rreth brezi edhe pse nuk ka parë ndonjë send.

Nga arsyeja se këta dëshmitarë dëshmuar për ngjarjen e njëjtë edhe dëshmitë e tyre do të vlerësohen bashkërisht e që përmbajtja e tyre ishte e saktë që të dy dëshmitarët përshkruan ngjarjen në mënyrë të natyrshme dhe të thjeshtë posaçërisht faktin e rëndësishëm se i akuzuari mbante dorën te brezi edhe pse asnjëri nga ta nuk pa revole apo send tjetër tek i akuzuari qartazi paraqet një mënyrë tipike të të akuzuarit për të frikësuar dëshmitarët dukshëm më të ri në moshë dhe nën këtë presion edhe tu merrte paratë nga kuletat e tyre.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit, A.A., vërtetohet se në vitin 2014, ka qenë duke u shëtitur me të dashurën tim A. B., tek lokalet e Radio dhe pasi që kanë hyrë në këtë lokal në katin e dytë ka ardhur një person i cili ka filluar të bërtas duke thënë që kemi hyrë në pronën e tij, ashtu që ky person më vonë edhe ka kërkuar që t’ia jap kuletën dhe telefonat dhe atë një iPhone dhe një telefon Nokia, e pastaj IPhonin dhe kuletën ia ka kthyer kurse telefonin Nokia e ka mbajtur, po ashtu ka kërkuar edhe nga A.B. telefonin dhe kuletën e që në fillim ka rezistuar

mirëpo më vonë nga frika ia ka dhënë dhe nga kuleta ka marrë 60€ ndërsa të tjerat 5€ i ka lënë dhe ia ka kthyer edhe telefonin po ashtu i akuzuari i ka thënë që ta thërras në telefon përkatësisht në një numër që ai ia ka dhënë që të shkoj dhe ti marr sendet që i kishte marrë, e menjëherë rastin e ka paraqitur në polici e që pas kësaj policia së bashku me të kanë shkuar deri tek vendi ku kishte ndodhur ngjarja dhe aty kanë takuar tani të akuzuarin dhe policia e kanë ndjekur atë por nuk kanë arritur që ta kapin. Po ashtu dëshmitari ka shtuar faktin se të akuzuarit nuk i ka vërejtur se ka pasur ndonjë revole por se i ka thënë qiti paret mos të nxjerri diçka, kurse ka paraqitur kërkesë pasurore – juridike shumë e marrë prej 60€.

Përmes dëshmisë së dëshmitarit A.T.2, është vërtetuar fakti se derisa kanë qenë duke shëtitur në parkun Liria në Ferizaj, së bashku me shokët e tij V.A.2 e N.M., përkatësisht kanë qenë të ulur në bankë dhe me vete ka pasur edhe qenin e tij të racës Pit bull është afruar tani i akuzuari të cilin me emër nuk e ka njohur dhe fillimisht kanë bërë një bisedë me të rreth qeneve e që më i ka thënë që e ka një qenë në stallë në LLoshkobare ashtu që janë nisur që të katërt së bashku rrugës në një momente gjatë bisedës i akuzuari k thënë se punon pastrues në polici ashtu që i ka pyetur përdorin bari e që më vonë ka kërkuar që ti dorëzojnë kuletat ashtu që nga kuleta ka marrë një shumë prej 8 eurove si dhe një iPhone 5, kurse nga V.A.2 pasi ka marrë një telefon ashtu që kartelën ia ka marrë kurse telefonin ia ka kthyer e pasi që janë larguar nga aty ky person na ka thënë mos të kthehemi mbrapa meqë do të i vraste e që nga frika nuk e kanë kthyer kokën mbrapa meqenëse e ka parë se e kishte pasur një revole me ngjyrë të zezë gjithashtu shton se rastin të nesërmen e ka paraqitur në polici.

Dëshmi pothuajse të njëjtë ka paraqitur edhe dëshmitari, V.A.2, i cili ka vërtetuar faktin se me dt. 26.01.2014 deri sa ishin së bashku me shokët e tij A.T.2 e N.M. ka shkuar i akuzuari i cili u ka thënë se a po vini me marr një Pit bull te F.J. ashtu që duke shkuar rrugës ka nxjerrë revolen dhe u ka thënë që të gjitha sendet që i keni në gjepa ti nxjerrim dhe ia kanë dhënë kuletat dhe nga kuleta e tij ka marrë shumë prej 5 euro, një kartelë telefoni, një shalle dhe një kapelë, më pastaj u ka thënë që të largohemi nga aty dhe të mos e kthejmë kokën mbrapa dhe kanë shkuar në shtëpitë e tyre.

Dëshmia e dëshmitarit N.M. vërtetohet se nuk ditën kritike kanë qenë duke qëndruar tek “Parku i Lirisë”, me dy shokë A.T.2 dhe V.A.2 dhe kanë takuar tani të akuzuarin i cili fillimisht nga ka thënë se e ka një qen - Pitt Bull, e të cilin e kishte vendosur një shtallë, e pas kësaj i njëjti ka biseduar me A.T.2 dhe V.A.2 dhe nga A.T.2 ka marrë një iPhone kurse nga V.A.2 e ka marrë një telefon gjithashtu ka kërkuar edhe nga dëshmitari kuletën por nuk ia ka dhënë.

Dëshminë e këtyre tre dëshmitarëve, Gjykata e ka vlerësuar si dëshmi objektive dhe të saktë për më tepër nuk u gjet ndonjë rrethanë as objektive dhe as subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e dëshmitarëve, meqë ngjarjen e përshkruan natyrshëm dhe në hollësi për më tepër dëshmitë e tyre e plotësojnë njëra-tjetrën.

Nga dëshmia e dëshmitarit A.O. është vërtetuar se me dt. 22.02.2015 pasi ka përfunduar orarin e punës rreth orës 16:00, ka marrë veturën Golf ngjyrë e kaltër e që së bashku me dy shokët e tij L.P. dhe D.H. janë nisur për Ferizaj, deri sa kanë qenë jashtë veturës ka dëgjuar një zë mashkulli i cili ka bërtitur ndalu- ndalu dhe që të tre kanë hyrë në veturë e po ashtu aty kanë hyrë edhe 2 persona që deri atëherë nuk i ka njohur, duke specifikuar se njëri nga ta është tani i akuzuari Sh.T. e që fillimisht ky person e ka kapur për dore e gjoksi dhe e ka nxjerrë një armë e cila ka qenë e gjatë e që këtë armë e ka drejtuar kah dëshmitari duke e puthitur për kokën e tij e duke i thënë se është person që po e ruan këtë pronë e po ashtu ka kërkuar që të nxjerrin sendet nga gjepat që kishim mirëpo përkundër faktit që i ka kontrolluar në kuletat asgjë nuk ka marrë edhe pse kanë pasur që të shkojmë në Ferizaj, Sh.T. ka kërkuar që dy shokët e mi ti dërgoi në shtëpitë e tyre, kurse tërë rrugës ka qëndruar mbrapa dhe armën e ka mbajtur në pjesën e belit.

Më tutje dëshmitari ka shtuar faktin se pasi i kanë lënë në rrugë D.H. dhe L.P., kanë vazhduar në shtëpinë e tij në fsh., ashtu që të njëjtit kanë bujtur në shtëpinë e vëllait e që tërë kohën ka qenë i zgjuar kurse këta dy persona kanë fjetur e që gjatë tërë kohës Sh.T. ka biseduar me persona të ndryshëm në telefon e që përmbajtja e bisedës ka qenë me disa persona rreth lajmërimit që ata i kishin bërë në polici, gjithashtu të nesërmen ka pasur që të shkojë në punë dhe pasi që i ka dërguar deri te marketi “.....” afër stacionit të autobusëve Sh.T. ka kërkuar që ta merr deri në ora 16 pasi që ta përfundoi punën edhe pse fillimisht ka kundërshtuar nga frika ia ka dhënë veturën dhe deri sa ka përfunduar orari i punës i njëjti e ka mbajtur në posedim veturën, e gjithashtu më tutje në dëshminë e tij ka pohuar faktin se të akuzuarin nuk e ka njohur më herët përkatësisht për herë të parë e ka parë kur e ka takuar tek vetura e tij dhe është prezantuar si Sh.T. Pushka.

Sa i përket dëshmisë së këtij dëshmitari (A.O.) Gjykata e ka vlerësuar në mënyrë tejet të kujdesshme dhe për arsyet që do ti paraqesim në vijim, së pari se nga kjo dëshmi është konstruktuar skeleti i akuzës ndaj të akuzuarit përkitazi me këtë pikë dhe është dëshmitari i vetëm okular që ka pasur njohuri për tërë ngjarjen prej marrjes së tij dhe të dëshmitarëve tjerë

(L.P. dhe D.H.) pastaj shkuarjen dhe qëndrimin në shtëpinë e tij për të vazhduar me ditën e nesërmë me marrjen e veturës së tij.

Por padyshim se vlerësimi i kësaj dëshmie është mjaft komplekse dhe i vështirë, për faktin se dëshmia ka qenë kyçe përkitazi me këtë pikë të kësaj aktakuze dhe se përkundër faktit që i njëjti ishte i dëmtuar me këtë çështje megjithatë dëshmia e tij ishte e saktë dhe e plotë, dëshmitari sqaroi ngjarjen deri në detaje dhe se paraqiti dëshmi të logjikhme dhe të natyrshme dhe se paraqiti dëshmi të rëndësishme së paku për dy çështje të rëndësishme

Dëshmi identike ka dhënë edhe dëshmitari L.P. duke pohuar faktin se me dt. 22.02.2015 së bashku me shokët e tij D.H. dhe A.O. janë nisur për Ferizaj duke shkuar rrugës së vjetër në fsh. Rakaj, ashtu që kur kanë arritur tek stalla e dhënëve në fsh. Rakaj dhe kanë dalur jashtë automjetit kanë dëgjuar një zë duke bërtitur dhe nga frika kanë hyrë në veturë e po ashtu në veturë hypën edhe dy persona tjerë dhe atë së pari i kanë maltretuar kurse i akuzuari Sh.T. e ka mbajtur revolen në kokë të A.O. duke kërkuar që të nxjerrin gjithçka nga xhepat dhe i njëjti i ka kontrolluar por nuk ka marrë asgjë e pastaj kanë hipur që të gjithë në automjetin e A.O. e që rrugës tek vendi i quajtur Kryqi i flamujve kanë parë policinë e që Sh.T. ka kërkuar që të vozisin sa më shpejtë e që pasi kanë kaluar policinë në distancë 500-700 dëshmitari dhe D.H. kanë zbritë nga automjeti kurse A.O. së bashku me Q.U. dhe Sh.T. kanë shkuar rrugës në drejtim të fsh. Elezaj. Më tutje dëshmitari ka shtuar faktin se pasi që kanë zbritu nga automjeti kanë menduar ta lajmërojmë policinë por nuk kanë guxuar që të ndërmarrim një veprim të tillë nga fakti se i akuzuari kishte armë me vete dhe e kishte edhe A.O. me vehte.

Nga dëshmia e dëshmitarit D.H. është vërtetuar se me dt. 22.2.2015 kanë vendosur që së bashku me dy shokët e tij A.O. dhe L.P. të shkojmë në Ferizaj për të festuar ditëlindjen e tij dhe pasi që A.O. nuk posedon patentë shofer kanë shkuar rrugës së vjetër të fsh. Rakaj e që pasi janë ndalur dhe kanë dalur nga vetura kanë dëgjuar një zë dhe meqenëse ishte mbrëmje na është ofruar një person e që ne me të shpejtë kanë hyrë në veturë mirëpo personi ka trokitur në dritare ka kërkuar që ta hapim atë dhe pasi A.O. e ka hapur dritaren e automjetit personi që më vonë kam kuptuar është Sh.T. e ka tërhequr për gjoksi me njëren dorë kurse me tjetrën i ka drejtuar armën në kokë. Më tutje dëshmitar ka shtuar faktin se pastaj i ka zbritur nga automjeti duke i mbajtur rreth dy orë aty vazhdimisht duke i maltretuar, duke kërkuar që ti nxjerrin krejt çka kishim në gjepa duke i kontrolluar edhe sendet dhe tërë kohën e ka mbajtur armën në drejtim të tyre kurse më vonë i ka thënë A.O. që këta kullera ti qojmë në shtëpi ashtu që të pesë kanë

shkuar në fsh. Elezaj dhe aty kanë zbritur dëshmitari dhe L.P. kurse A.O. me këta dy persona kanë vazhduar rrugën në drejtim të vendit të quajtur “Te Lushi”.

Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë objektive dhe të sakta për më tepër edhe të besueshme në tërësinë e tyre, gjithsesi duhet qartësuar se këta dëshmitar paraqitën të dhëna relevante për një pjesë të ngjarjes dhe atë prej momentit të marrjes së tyre (fshati Rakaj tek ferma e deleve) qëndrimi i tyre dhe deri tek shkuarja dhe zbritja e tyre në fshatin Elezaj, gjithsesi dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve plotësohen edhe me dëshminë e dëshmitarit A.O. sidomos në rrethanat e njohjes paraprake të të akuzuarit me A.O. e që dëshmitarët demantuan në tërësi të akuzuarin i cili gjatë mbrojtjes së tij pohoi faktin se e ka njohur A.O. dhe se ka pasur raporte të biznesit me të.

Është tejet interesant dhe i pashpjegueshm fakti se cila ishte arsyeja se dëshmitarët nuk e paraqitën rastin në polici pas largimit të tyre nga automjeti dhe vazhdimi i rrugëtimit të këtyre personave me A.O., por megjithatë ky fakt është i vetëkuptueshëm dhe ndërlidhet me frikën e madhe që kishin përjetuar dëshmitarët si pasojë e sjelljes agresive (vazhdimisht me armë në dorë) së të akuzuarit.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar provat materiale përkatësisht përmes shikimit dhe leximit në zinxhirin e ruajtjes të dt. 24.02.2014, përmes shikimit dhe leximit në vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve të dt. 19.01.2014, ku nga dëshmitari Sh.H. janë konfiskuar një xhamper, një palë pantallona dhe një palë këpucë, përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku janë marrë nga Sh.H. gjithashtu një jakne ngj. e zezë, një palë patike Rebook ngjyrë të zezë dhe një telefon i tipit Samsung, përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku janë marrë nga T.G. gjithashtu një jakne ngj. e zezë, një palë patike Rebook ngjyrë të zezë dhe një telefon i tipit Samsung, përmes leximit në vërtetimin për kthimin e sendeve dhe për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 28.01.2014, ku Sh.T. i janë kthyer sendet një xhamper ngjyrë hiri pantallona ngj. të kaftë dhe këpucë ngj. të zezë si dhe dhe shikimit dhe leximit në vërtetimi tërheqja e parave te dhe përmes shikimit dhe leximit në zinxhirin e ruajtjes të dt. 23.02.2015, ku janë konfiskuar sendet si në vijim: një pistoletë punë dore, një letërnjoftim, një kartelë e studentit, 4 kartela të telefonave dhe atë një e valës një e ipkos dhe dy z-mobile.

Duhet potencuar faktin se të gjitha këto prova materiale janë të besueshme meqë janë lëshuar nga autotitetet policor por megjithatë edhe vet i akuzuari nuk i konteston disa fakte të vërtetuara përmes këtyre provave materiale.

Ekipi i përbërë nga tre ekspertë pas ekspertimit të hospitalizuar prej dt. 01.09 – 08.09.2014 si dhe ekzaminimi ambulator prej dt. 25.02.2015 – 02.03.2015, ka përpiluar raportin bazuar në analizat e sjelljes së të akuzuarit dhe ka konstatuar se është person me çrregullim mendor të quajtur çrregullim i personalitetit kufitar –*borderline e klasifikuar si sëmundje mendore F60.3*, duke përfunduar me konstatimin se llogaritshmëria e gjyqimit për rëndësinë e veprës dhe veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar (e konstatuar përmes shikimit dhe leximit në ekzaminimin psikiatrik të dt. 11.03.2015).

Përmes shikimit dhe leximit në njoftimin nga Qendra e Korrektuese e Kosovës – Dubravë e dt. 29.05.2015, demantohet pohimet e të akuzuarit se në kohën kur pretendohet se ka kryer disa nga këto vepra penale ka qenë i burgosur, por se përmes njoftimit është vërtetuar se i akuzuari në këtë periudhë kohore ka qenë në liri, i cili njoftim ishte i rëndësishëm dhe i besueshëm meqë ishte lëshuar në bazë të të dhënave të siguruara nga autoriteti kompetent për mbajtjen e paraburgimit dhe vuajtjen e dënimit e specifikuar edhe kohën dhe periudhën kohore kur i akuzuari ishte në këtë qendër.

Kurse përmes shikimit në fotografi shihen pistoleta –arma prodhim dore dhe rrobat e të akuzuarit dhe se këto nuk kontestohen as nga vet i akuzuari.

5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore e po ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në paraqitjen e mbrojtjes së tij se nuk ka kryer veprat penale në fjalë, por megjithatë në mbrojtjen e tij i akuzuari (edhe pse nuk ka pranuar fajësinë) nuk i konteston disa nga faktet për disa vepra penale.

Porse mbrojtja e të akuzuarit nuk është vërtetuar as edhe me një provë tjetër pos mbrojtjes së të akuzuarit, për më tepër është demantuar edhe nga vet dëshmitarët okular e që mbrojtja e të akuzuarit ishte tejet konfuze pa asnjë lidhmëni as logjike e as juridike, për më tepër mbrojtja e tij ishte edhe dezorientuese dhe arsyetimi i tij është aq i pabesueshëm sidomos në pjesën se kinse (V.T., N.M. dhe A.T.2) kanë vjedhur në shtallën ku po punonte i akuzuari e gjithashtu mbrojtje të ngjashme ka sajuar edhe për të dëmtuarit Sh.H. dhe V.A.1.

Gjithashtu edhe përkitazi me të dëmtuarin A.O. i akuzuari ka pranuar disa nga faktet por ka mohuar faktin se me dhunë i ka marrë automjetin të dëmtuarit se kinse kanë pasur disa biznese të përbashkëta. Edhe në këtë pjesë i akuzuari paraqiti mbrojtje tërësisht të pabesueshme dhe thjesht e fabrikoi në tërësi mbrojtjen e tij dhe arsyetimet ishin tërësisht të pabesueshme e sidomos në pjesën se më parë e ka njohur dëshmitarin A.O. e që në tërësi janë demantuar edhe nga vet dëshmia e dëshmitarit se asnjëherë më parë nuk e ka parë dhe nuk e ka njohur të akuzuarin dhe nuk ka pasur kurrfarë lidhje me të.

Dhe në fund sa i përket rasteve tjera i akuzuari ka zgjedhur mënyrën e mbrojtjes mjaft të thjeshtë se nuk i njeh këta persona se asnjëherë nuk i ka parë asnjëherë nuk ka pasur kontakte me ta.

Po ashtu edhe kjo mbrojtje e tij është demantuar në tërësi nga dëshmitarët e dëgjuar dhe se të gjithë e njohën të akuzuarin se pikërisht ishte personi që kreu këto vepra penale.

6. Vlerësimi i tezës së mbrojtësit të të akuzuarit

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit av. Z.Z., të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka pretenduar se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer asnjë vepër penale dhe ka kërkuar lirimin e tij nga të gjitha aktakuzat.

Kurse dëshmitarët e dëgjuar i ka cilësuar si dëshmitar jo të besueshëm dhe jo objektiv se në fakt dëshmitarët V.T., N.M. dhe A.T.2 i ka njohur më herët dhe se qëllimi nuk ka qenë marrja e sendeve pasi që edhe të nesërmen ia ka kthyer. Gjithashtu nuk janë vërtetuar edhe veprat tjera e posaçërisht ndaj A.O. se janë njohur mes vete dhe se raportet e tyre kanë qenë shoqërore.

Por Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë, se dëshmitarët e dëgjuar (të cilat dëshmi janë elaboruar hollësisht në pjesë ku janë elaboruar dëshmitë e dëshmitarëve) e për më tepër edhe identifikimin e kanë bërë mjaft qartazi se ishte pikërisht i akuzuari që kishte kryer këto vepra penale.

Po ashtu në kontest të kësaj pothuajse në secilin rast ishin më tepër se një dëshmitar dhe se dëshmitarët e plotësuan njëri-tjetrin dhe se dëshmitë e tyre gjithashtu u plotësuan edhe me prova materiale.

7. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale për shkak të veprës penale në vazhdim grabitja nga neni 329 par. 1 i KPRK-së, meqë i akuzuari në periudhë kohore prej disa muajve dhjetor 2013 deri me muajin janar 2014, kishte kryer gjashtë vepra penale të kësaj natyre njëjti pasi që paraprakisht kishte biseduar me të dëmtuarit kishte vepruar në mënyrë të ngjashme duke u prezantuar si polic duke iu kërkuar paratë dhe telefona të cilat i përvetësonte në mënyrë të kundërligjshme, kurse me rastin e kualifikimit si vepër penale në vazhdim posaçërisht dispozitën e nenit 81 të KPRK-së dhe ka konstatuar se janë plotësuar tri nga kushtet e kërkuara *objekti i njëjti i veprës penale* (vepra e njëjtë e grabitjes), *vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale* (veprat e kryera në territorin e Ferizajt dhe brenda hapësirës kohore prej dhjetorit 2013 deri në muajin janar 2014) dhe *dashja e njëjtë e kryerësit* (qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm pasuror), po ashtu janë plotësuar edhe elementet e veprës penale veprës penale detyrimi nga neni 340 par. 2 të KPRK-së, meqë bëhet fjalë për detyrim të të dëmtuarit që të veproj në em të pasurisë së tij duke përdorur një metodë mjaft perfide dhe agresive duke e mbajtur vazhdimisht nën kontrollë të dëmtuarin, gjithashtu është vërtetuar elementi subjektiv i veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, meqë edhe vet i akuzuari pohoi faktin se këtë armë e posedonte por se nuk e kishte në posedim momentin kur është zbuluar në vendin ku paraprakisht e kishte fshehur dhe gjithsesi është e pakontestueshme se i akuzuari nuk kishte leje përkatëse për këtë armë.

8. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari është i moshës relativisht të re mirëpo kjo rrethanë e natyrës minore krahasuar me rrethanat rënduese që gjeti tek i akuzuari dhe atë në mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale se veprimet e tij ishin dukshëm më të rënda duke vepruar me vrazhdësi dhe agresivitet ndaj të dëmtarëve përkatësisht duke i selektuar të dëmtuar të moshave kryesisht të reja dhe duke realizuar synimin e tij dhe posaçërisht sjellja e tij agresive.

Megjithatë, Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit posaçërisht kishte parasyshë konstatimet e ekspertizës së Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës i cili konstatoi se i akuzuari është person me çrregullim mendor të quajtur çrregullim i personalitetit kufitar – *borderline e klasifikuar si sëmundje mendore F60.3*, e cila karakterizohet me sjellje antisociale, mungesë të empatisë, mungesë të konsideratës, superego të dobët mos mësim nga pësimet,

tendenca agresive impulsive, raporte të brishta nder personale, tendenca për veprime antisociale i cili çrregullim i ka rrënjët thellë në zhvillimin dhe pjekurinë e tij si personalitet. Disponim të ndryshuar, tendenca heteroagresive dhe autoagresive dhe mospërfillje e normave dhe rregullave shoqërore dhe rendeve shtëpiake duke përfunduar me konstatimin se llogaritshmëria për gjykimi për rëndësinë e veprës dhe veprimeve të tij ka qenë e zvogëluar, ashtu që në aplikim të dispozitës së nenit 18 të KPRK-së:

“ Person i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.”

Andaj në aplikim të kësaj dispozite vlerëson se për shkak të gjendjes së tij shëndetësore se edhe me dënimin e shqiptuar në minimumin ligjor edhe pse kishte dukshëm më shumë rrethana të natyrës rënduese megjithatë është e justifikueshme edhe përmes këtij dënimi mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata është e bindur se me anë të këtyre dënimeve është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, dhe se me anë të këtyre dënimeve do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

9.Konfiskimi, llogaritja e paraburgimit, kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme arma pistoletë punë dore, meqë sipas kësaj dispozite është përcaktuar konfiskimi obligativ i saj.

Konform nenit 83 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit është llogaritur paraburgimi dhe qëndrimi në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës, prej dt. 28.01.2014 deri më 04.10.2014 si dhe nga dt. 23.02.2015 deri më 15.07.2015.

Konform nenit 463 par.2 të KPP-së, të dëmtuarit E.E., A.A.1, Sh.H., V.A.1, A.T.1, A.T.2, V. A.2, M.N. L.R. dhe A.O., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil, meqë nga të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk është arritur të vërtetohen

në mënyrë të plotë e as të pjesërishtme kërkesat e tyre kurse ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarit Rr.H., t'ia kthej shumën prej 350€, të dëmtuarit Xh.K., shumën prej 190€ dhe të dëmtuarit A.A. shumën prej 60€, meqë këto shuma kanë qenë vlera monetare të përcaktuara qartë, kurse N.M. nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 /njëqind/€, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Sa i përket dispozitivit të parë dhe të tetë të aktakuzës fillestare përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga aktakuza, meqë nga provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale në fjalë.

Konform nenit 463 par.3 të KPP-së, të dëmtuarit: E.E., M.N. L.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil, meqë për këto dy pika të aktakuzës, Gjykata ka marrë aktgjykim refuzues pas tërheqjes nga ana e Prokurorit të Shtetit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
me PKR.nr.57/2015 me dt.20.07.2015**

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.